

DASANTILA TAHIRAJ

Datëlindja: 18.10.1972

Vendlindja: Elbasan

Email: Dasantila.Tahiraj@parlament.al



Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet në vitin 1995 për mjekësi të përgjithshme në Universitetin e Tiranës. Gjatë viteve 1990-1995 ka kryer studime post universitare në fushën e dermatologjisë dhe më vonë (2014) ka përfunduar studimet doktorale po në këtë drejtim.

Në vitin 2016 ka marrë titullin Profesor i Asociuar në Dermatologji në Universitetin e Elbasanit.

Pas përfundimit të studimeve (1996-1997) ka punuar si mjeke e përgjithshme në Kujdesin Shëndetësor, Elbasan.

Ajo ka punuar si pedagoge: Fakultetin e Infermierisë në Elbasan në 1996-1997, në Universitetin Elena Gjika gjatë viteve 2001-2006 dhe në Universitetin e Elbasanit në vitet 2013-2015.

Gjithashtu, ka punuar si mjeke dermatologe në Spitalin Rajonal Elbasan gjatë periudhës 2006-2013.

Z. Tahiraj ka mbajtur pozicionet e zv. drejtores dhe drejtores në disa institucione të ndryshme shëndetësore si: Zv.drejtoreshë në Departamentin e Shëndetit Publik, Elbasan (1997-2001), Drejtoreshë në Kujdesin Shëndetësor Parësor (2001-2005), Drejtoreshë e Spitalit Rajonal Elbasan (2013-2021).

Z. Tahiraj është mandatuar si deputete e legjislaturës së X-të në Qarkun e Elbasanit, në siglën e Partisë Socialiste.

